



RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS 1 JANAR – 30 QERSHOR 2025

AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Raporti gjashtëmujor i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për periudhën 1 janar– 30 qershor 2025 ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve, të arriturve dhe sfidave të Agjencisë në përmbushje të mandatit të saj për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Raporti reflekton angazhimin e vazhdueshëm të Agjencisë për të garantuar të drejtat themelore të qytetarëve përmes trajtimit të ankesave, ofrimit të këshillave ligjore, zhvillimit të fushatave ndërgjegjësuere dhe intensifikimit të bashkëpunimit institucional, përfshirë partnerët ndërkombëtarë dhe rajonal.

Në përmbushje të mandatit të saj ligjor, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka pranuar gjithsej **544 ankesa** për të drejtën e qasjes në dokumente publike dhe të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Nga ky numër, **431** ankesa janë përfunduar, ndërsa **113** janë në proces të shqyrtimit. Respektivisht, në fushën e **qasjes në dokumente publike** janë pranuar **462** ankesa prej të cilave **292** janë përmbyllur dhe **170** janë në shqyrtim. Ndërsa, në fushën e **mbrojtjes së të dhënave personale**, janë pranuar **82 ankesa**, nga të cilat **59** janë përfunduar, kurse **23** janë në proces të shqyrtimit.

Në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka realizuar gjithsej **196 inspektive**. Nga këto, **125 inspektive** janë realizuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa **71 inspektive** janë realizuar sipas ankesave të adresuara në Agjenci.

Ndërsa, me qëllim të harmonizimit të kuadrit ligjor me standardet evropiane, Agjencia ka vazhduar veprimet për hartimin e **Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Institucionet e Zbatimit të Ligjit**, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (e njohur si Law Enforcement Directive – LED). Paralelisht, në përmbushje të funksionit të saj ligjor, Agjencia ka ofruar **29 këshilla ligjore** për institucione publike, subjekte private dhe individë, si dhe është angazhuar në **20 aktivitete gjyqësore**, përfshirë përgjigje ndaj padive, paraqitje të ankesave dhe përfaqësim në seanca gjyqësore.

Aktivitetet e Agjencisë në vitin 2025 janë përqendruar në thellimin e bashkëpunimit me institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe sektorin e mediave, duke promovuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike përmes trajnimeve, punëtorive dhe fushatave ndërgjegjësuere. Në këtë kontekst, gjatë periudhës janar–qershor 2025, janë realizuar **20 aktivitete informuese** dhe janë trajnuar **mbi 450 pjesëmarrës nga sektori publik dhe privat**, përfshirë zyrtarë publik, kontrollues dhe përfaqësues nga grupe tjera të interesit, nga sektori i shëndetësisë, sistemi bankar, qendrat sociale, organizatat joqeveritare dhe mediat. Nga këto trajnime, **227 pjesëmarrës janë certifikuar për mbrojtjen e të dhënave personale**, duke reflektuar përkushtimin e Agjencisë në ngritjen e standardeve të zbatimit të ligjit në praktikë.


Si pjesë e përpjekjeve për promovimin e arritjeve të Kosovës në fushën e qasjes në informacion dhe për forcimin e pozicionit të saj ndërkombëtar, më 7–8 prill 2025, Agjencia ka organizuar për herë të parë në vend “Punëtorinë Ndërkombëtare për Lirinë e Informacionit”. Ngjarja mbledhi përfaqësues të autoriteteve evropiane për qasje në dokumente publike nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria,

Zvicra, Portugalia, Spanja, Skocia, Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Zyra e Avokatit të Popullit të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të angazhimeve për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjen e prezencës institucionale në platformat evropiane, sukcesi i Agjencisë në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025 karakterizohet me anëtarësimin në **Komitetin Drejtues të Rrjetit Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI)**. Ky anëtarësim, që u formalizua gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), të mbajtur më 24 qershor 2025 në Berlin, paraqet një kontribut konkret në integrimin e Kosovës në rrjetet ndërkombëtare të politikbërjes në fushën transparencës dhe të drejtës për informim.

Përmes ekspertizës profesionale dhe me qëllim të mbështetjes së kontrolluesve dhe përpunuesve nga sektori publik dhe privat në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe standardizimin e qasjes gjatë përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës, gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka finalizuar dhe publikuar **katër** Udhëzues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përkatësisht:

1. Udhëzuesi për Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor
2. Udhëzuesi për Vlerësimin e Ndikimit mbi Mbrojtjen e të Dhënave (VNMDH)
3. Udhëzuesi për Njoftimin e Shkeljeve të të Dhënave Personale
4. Udhëzuesi për Ligjshmërinë e Përpunimit të të Dhënave Personale



MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE


Në përputhje me mandatin ligjor të përcaktuar me **Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka ushtruar funksionet e saj mbikëqyrëse dhe udhëzuese përmes inspektimeve, shqyrtimit të ankesave, nxjerrjes së vendimeve, si dhe përmes veprimeve ndërgjegjësuere dhe hartimit të materialeve udhëzuese për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Me qëllim të standardizimit të qasjes në trajtimin e ankesave dhe forcimit të veprimeve mbikëqyrëse, Agjencia ka finalizuar kornizën e brendshme procedurale, përmes hartimit të:

- **Rregulloren për Inspektim,**
- **Rregulloren për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave,**
- **Listën e Kontrollit për Inspektim, dhe**
- **Formularin e Procesverbalit të Inspektimit.**


INSPKETIMET

Përkitazi me autorizimet ligjore të përcaktuara me ligj, gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka realizuar gjithsej **196 inspektime**, prej të cilave **125 inspektime** janë realizuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa **71 inspektime** sipas ankesës. Nga numri i përgjithshëm i inspektimeve, **179 inspektime** janë realizuar në sektorin privat ndërsa **17 inspektime** janë realizuar për sektorin publik. Sektorët në të cilët janë realizuar inspektimet sipas detyrës zyrtare përfshijnë **10 inspektime** për kontrollues publik dhe **115 inspektime** për kontrollues privat.




Fushat në të cilat janë realizuar inspektimet:

- 49 inspektime lidhur me përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë;
- 40 inspektime në sektorin shëndetësor, përkatësisht laboratorë, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale;
- 18 inspektime për vlerësimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrollues të ndryshëm;
- 8 inspektime lidhur me publikimin e të dhënave personale;
- 3 inspektime lidhur me shpërndarjen e të dhënave personale;
- 3 inspektime në sektorin e sigurimeve shëndetësore;
- 3 inspektime për rastet e rrjedhjes së të dhënave personale;
- 1 inspektim lidhur me përpunimin e të dhënave personale që përfshijnë karakteristika biometrike.




ANKESAT

Në periudhën raportuese, janë pranuar gjithsej **82 ankesa**, prej të cilave **59** kanë përfunduar, **23** ankesa janë në proces të shqyrtimit dhe **12** ankesa janë bartur nga viti 2024.



Natyrat e ankesave janë:

- 24 ankesa për vëzhgim me kamerë;
- 21 ankesa për publikim të të dhënave personale;
- 14 ankesa për marketing të drejtpërdrejtë;
- 9 ankesa për keqpërdorim të të dhënave personale;
- 5 ankesa për shpërndarje të të dhënave personale;
- 3 ankesa për përpunim të të dhënave pa bazë ligjore;
- 4 ankesa për refuzim të kërkesës për qasje në të dhëna personale;
- 1 ankesë lidhur me masat e sigurisë;
- 1 ankesë për refuzim të kërkesës për fshirjen e të dhënave personale



Gjatë periudhës raportuese janar–qershor 2025, Agjencia ka nxjerrë gjithsej **71 vendime** lidhur me ankesat e adresuara, prej të cilave **59 vendime** janë nxjerrë **për ankesat e vitit 2025**, ndërsa **12 vendime** janë nxjerrë **për ankesat e pranuar në vitin 2024**.


Si rezultat i inspektimeve të realizuara sipas detyrës zyrtare dhe në kuadër të trajtimit të ankesave, Agjencia ka shqiptuar gjithsej **pesë (5) gjoba kundërvajtëse** ndaj kontrolluesve, për shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjobat e shqiptuara përfshijnë:

1. **Universiteti “Isa Boletini” – Mitrovicë:** Gjobë në vlerë prej **20,000 euro**, për publikimin e të dhënave personale;

2. **Kontrolluesi “Proex-Interex”**: Gjobë në vlerë prej **8,000 euro**, për vendosjen dhe përdorimin e sistemeve të vëzhgimit me kamera;
3. **KESCo – Prishtinë**: Gjobë në vlerë prej **25,000 euro**, për publikimin e të dhënave personale të konsumatorëve;
4. **Shoqëria “Asistenca Rrugore”**: Gjobë në vlerë prej **4,000 euro** për publikimin e të dhënave personale;
5. **Kompania Rajonale e Ujësllësit “Prishtina”**: Gjobë në vlerë prej **25,000 euro** për publikimin e të dhënave personale;

Të gjithë kontrolluesit ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa ndëshkuese kanë zbatuar vendimet e Agjencisë, dhe gjobat janë paguar në tërësi në përputhje me afatet ligjore.

Në vazhden e përpjekjeve për forcimin e mekanizmave mbrojtës në fushën e të dhënave personale, më 28 janar 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi, me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, ka prezantuar platformën për identifikimin e rrjedhjes së të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat. Kjo platformë synon të përmirësojë ndjeshëm zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe do të funksionojë si një mekanizëm parandalues ndaj keqpërdorimeve të mundshme të të dhënave personale.



QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE


Gjatë periudhës raportuese, duke vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore në fushën e qasjes në dokumente publike, Agjencia ka vazhduar trajtimin e ankesave të adresuara përkitazi me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe forcimin e transparencës së institucioneve, Agjencia ka vazhduar monitorimin e institucioneve për publikimin me vetiniciativë të dokumenteve nga Institucionet Publike.


ANKESAT

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka pranuar **462** ankesa nga qytetarët, shoqëria civile dhe mediumet, ndërsa ka bartur **80** ankesa për shqyrtim nga viti 2024, duke arritur në total **542** ankesa për shqyrtim. Nga ky numër, janë mbyllur **372** ankesa, duke ndjekur procedurat e përcaktuara nga akti i brendshëm për shqyrtimin e ankesave.

Vlen të theksohet se numri më i madh i ankesave të mbyllura është bërë përmes shkresës së parë njoftuese të Agjencisë ndaj institucioneve për të cilat është parashtruar ankesë nga palët ankuese, përderisa Agjencia, në kuadër të shqyrtimit të ankesave ka realizuar edhe takime me palët në procedurë me qëllim të përshejtimit dhe lehtësimit të shqyrtimit të lëndëve dhe për ofrimin e sqarimeve të nevojshme për palët në procedurë.




Ankesat e parashtruara në AIP gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2025 janë bërë nga këto kategori: **245** nga qytetarët (individët), **117** nga OJQ-të dhe **100** nga mediumet.




Institucionet ndaj të cilave janë parashtruar ankesat pranë AIP-së:

- 137 ankesa ndaj Komunave;
- 107 ankesa ndaj Ministrive;
- 52 ankesa ndaj Agjencive;
- 37 ankesa ndaj Ndërmarrjeve Publike;
- 23 ankesa ndaj Sistemit Gjyqësor;
- 32 ankesa ndaj Institucioneve të tjera;
- 19 ankesa ndaj ShSKUK-së;
- 15 ankesa ndaj Sistemit Prokurorial
- 12 ankesa ndaj Universiteteve Publike;
- 7 ankesa ndaj Policisë së Kosovës;
- 5 ankesa ndaj Zyrës së Kryeministrit;

- 5 ankesa ndaj Inspektorateve;
- 4 ankesa ndaj Bankës Qendrore të Kosovës;
- 3 ankesa ndaj Doganës;
- 2 ankesa ndaj Kuvendit;
- 1 ankesë ndaj Presidencës;
- 1 ankesë ndaj OSHP-së.



Nga gjithsej **372 vendime**, janë lëshuar **303 vendime përmbyllëse**, **57 vendime refuzuese** dhe **12 vendime** për gjobë administrative.




Forcimi i transparencës së Institucioneve- Publikimi pro aktiv i dokumenteve

Me qëllim të forcimit të transparencës së institucioneve publike, dhe ngritjes së nivelit të llogaridhënies, në përputhje me detyrimet ligjore, Agjencia, në mënyrë të vazhdueshme, monitoron faqet zyrtare të institucioneve publike, si një nga mekanizmat mbikëqyrës për zbatimin e publikimit pro aktiv të dokumente publike në kuadër të faqeve zyrtare të institucioneve publike, i cili praktikohet sipas kritereve të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 (janar–qershor), janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme faqet zyrtare të institucioneve publike. Monitorimi është realizuar përmes analizës së përmbajtjes së faqeve zyrtare të këtyre institucioneve, duke krahasuar dokumentet e publikuara me kërkesat ligjore dhe duke u bazuar në gjendjen faktike në momentin e vlerësimit.

Si rezultat i këtij procesi, janë dërguar **120 raporte monitorimi** institucioneve përkatëse, me të gjeturat si dhe rekomandime për publikimin me vetiniciativë të **6 kategorive të dokumenteve**, të identifikuara sipas kërkesave ligjore. Në gjashtëmujorin e të parë të vitit 2025, Agjencia ka identifikuar progres në përmbushjen e detyrimeve për publikimin me vetiniciativë të dokumenteve nga institucionet publike.



KËSHILLAT

Në përmbushje të funksionit të saj ligjor për ofrimin e këshillave lidhur me zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka ofruar **29 këshilla ligjore**, prej të cilave **14** këshilla janë ofruar për institucione publike, **11** për subjekte private, ndërsa **4** këshilla për individ.




Subjektet kërkuese dhe natyra e këshillave të ofruara:

Nr.	Subjekti kërkuës	Kërkesa
1.	G.R (qytetarë)	Kërkesë lidhur me procedurën e përpunimit të të dhënave
2.	Zyra për Çështje të Komuniteteve	Qasja në të dhënat lidhur me subvencionet
3.	MASHTI	Kërkesë lidhur me mundësinë e bartjes së të dhënave
4.	Kompania “INSIG”	Kërkesë lidhur me mundësinë e publikimit të të dhënave
5.	L.A (qytetarë)	Ofrimi i sqarimeve lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesi
6.	Shoqëria e Avokatëve “Bogaj Laë”	Sqarim lidhur me vendosjen e përfaqësuesit të kontrolluesit në Kosovë
7.	Kompania “OnixSpa” Kosovë	Ofrimi i sqarimeve lidhur me përpunimin e të dhënave personale të kontrolluesit

8.	E.S (qytetarë)	Sqarim lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga sektori bankar në Kosovë
9.	Kompania “Unifree DutyFree”	Kërkesë lidhur me lejueshmërinë e ofrimit të të dhënave sipas kërkesës së ATK
10.	TRUSTI	Kërkesë lidhur me lejueshmërinë e ofrimit të të dhënave sipas kërkesës së institucionit publik
11.	Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë	Përpunimi i të dhënave personale gjatë procesit të mbarëvajtjes së njoftimit për ligjërata të studentëve
12.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Përpunimi i të dhënave personale gjatë procesit votues
13.	Kompania “Vokshi & Lata”	Përpunimi i të dhënave gjeohapsinore në Kosovë
14.	Kompania “Neptun” Kosovë	Përpunimi i të dhënave personale të klientëve dhe të punësuarve në Neptun
15.	Kompania “SHDE KOSOVA”	Përpunimi i të dhënave personale nga blerjet në platforma online në Kosovë
16.	Administrata Tatimore e Kosovës	Përpunimi i të dhënave personale nga përdorimi i GPS në vetura zyrtare
17.	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Përpunimi i të dhënave personale gjatë procesit të administrimit të ankesave
18.	Platforma E-Kosova	Përpunimi i të dhënave personale
19.	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës	Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve
20.	Ordinanca “Rifjala” Prizren	Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve nga përdorimi i sistemit të vëzhgimit me kamerë
21.	Komuna Vushtrri	Përpunimi i të dhënave personale
22.	Ordinanca Logopedike “Lingua Med”	Përpunimi i të dhënave personale nga përdorimi i sistemit të vëzhgimit me kamerë
23.	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve
24.	Apple CO	Përpunimi i të dhënave GEO Location
25.	ATK & GIZ	Përpunimi i të dhënave personale nga njoftimi i qytetarëve
26.	Administrata Tatimore e Kosovës	Përpunimi i të dhënave personale
27.	NLB Bank Kosovo	Përpunimi i të dhënave personale nga sistemi i vëzhgimit me kamerë
28.	Administrata Tatimore e Kosovës	Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale
29.	Q.N (qytetarë)	Qasja në të dhënat personale të subjektit

PËRFAQËSIMI GJYQËSOR

Në kuadër të angazhimeve të përfaqësimit të Agjencisë në procese gjyqësore janë realizuar **20 aktivitete**, prej të cilave **11** përgjigje në padi, **2** Ankesa në Gjykatë të Apelit dhe **7** përfaqësime në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 janë finalizuar **4 udhëzues tematikë** dhe **4 dokumente mbështetëse** që shërbejnë si udhëzues praktik për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto materiale janë hartuar për të mbështetur kontrolluesit dhe përpunuesit publik dhe privat në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe për të standardizuar qasjen në përpunimin e të dhënave personale në harmoni me parimet e përgjegjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës, përkatësisht:

1. **Udhëzuesi për Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor**
2. **Udhëzuesi për Vlerësimin e Ndikimit mbi Mbrojtjen e të Dhënave (VNMDH)**
3. **Udhëzuesi për Njoftimin e Shkeljeve të të Dhënave Personale**
4. **Udhëzuesi për Ligjshmërinë e Përpunimit të të Dhënave Personale**

Për më tepër, për të forcuar bashkëpunimin me Organizatat Jo-Qeveritare për promovimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale janë nënshkruar **2 Memorandume të Bashkëpunimit**.

- **Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet AIP dhe NGO AKTIV;**
- **Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet AIP dhe Forumi Kosovar për Aftësi të Kufizuar;**

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE PËRFAQËSIMI

Duke e konsideruar si një nga prioritetet e Agjencisë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Agjencia ka intensifikuar angazhimin e saj në skenën ndërkombëtare përmes anëtarësimit në mekanizma evropianë, pjesëmarrjes në forume profesionale dhe organizimit të ngjarjeve me karakter ndërkombëtar në Kosovë.

Përkatësisht, suksesi i Agjencisë gjatë kësaj periudhe karakterizohet me anëtarësimin **në Komitetin Drejtues të Rrjetit Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI)**. Ky anëtarësim, që u formalizua gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), të mbajtur më 24 qershor 2025 në Berlin, shënon një arritje të rëndësishme në avancimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në fushën e transparencës dhe të drejtës për informim. Komiteti Drejtues ka rol qendror në koordinimin e aktiviteteve të rrjetit, hartimin e dokumenteve strategjike dhe menaxhimin e aplikimeve për anëtarësim, ndërsa përmes këtij anëtarësimi Agjencia synon të kontribuojë në ndarjen e praktikave të mira dhe promovimin e transparencës institucionale në nivel evropian.

Në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme për të afirmuar rolin e Republikës së Kosovës në agjendat ndërkombëtare sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike, Agjencia ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në aktivitetet ndërkombëtare dhe rajonale të mëposhtme:

1. ***Përfaqësimi në Takimin Plenar të 104-të i Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB)***, i mbajtur më 12 shkurt 2025 në Bruksel.
2. ***Përfaqësimi në Programin Ministerial***, i mbajtur më 3–5 mars 2025 në Barcelonë, me ftesë nga GSMA (Organizata e Grupit Special të Telefonisë Celulare), si dhe prezantimit në tryezën e rrumbullakët me temën “Sigurimi i Privatësisë së të Dhënave për të Ardhmen”.
3. ***Përfaqësimi në Samitin Global të Privatësisë 2025***, i mbajtur në Washington D.C., SHBA, me ftesë nga Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë (IAPP), ku Agjencia u përfshi në diskutimet globale mbi sfidat dhe të ardhmen e Inteligjencës Artificiale karshi mbrojtjes së të dhënave personale.

4. ***Përfaqësimi në Simpoziumin e Privatësisë 2025***, i mbajtur në Venecia, Itali, ku me ftesë të Presidentit të Simpoziomit, Sebastian Ziegler, Agjencia prezantoi në tryezën me temë “Përtej BE-së: Fuqizimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar ndërmjet Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave”.
5. ***Përfaqësimi në Seminarin për Ndërtimin e Kapaciteteve Kibernetike në Ballkanin Perëndimor***, i mbajtur më 19–20 maj 2025 në Podgoricë, me ftesë të Qendrës së Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor dhe Forumit Ekonomik Botëror.
6. ***Përfaqësimi në Takimin Plenar të 106-të i Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB)***, i zhvilluar më 3–4 qershor 2025 në Bruksel.
7. ***Përfaqësimi i Agjencisë në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC)***, e mbajtur në Berlin, 22–26 qershor 2025, me ftesë të Autoritetit Federal Gjerman, me c’rast u prezantuan të arriturat e Republikës së Kosovës në rritjen e trasnparencës dhe llogaridhënies në panelin “Shkëmbimi i sfidave dhe përvojave të suksesshme në fushën e qasjes në informata”.

Për më tepër, më 7–8 prill 2025, nën patronatin e Agjencisë, u organizua për herë të parë në Kosovë “Punësoria Ndërkombëtare për Lirinë e Informacionit”, një ngjarje që mbledhi autoritete nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria, Zvicra, Portugalia, Spanja, Skocia, Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Zyra e Avokatit të Popullit Evropian. Punësoria shërbeu si platformë për shkëmbim përvojash mbi transparencën në shpenzimet publike, qasjen në informata dhe mbrojtjen e të dhënave, duke afirmuar rolin e Kosovës si pjesë aktive e rrjeteve evropiane për të drejtën e informimit.

Në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, më 20–21 mars 2025, Agjencia priti në vizitë zyrtare delegacionin e Agjencisë Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të udhëhequr nga Komisioneri Zdravko Vukić, njëherit Zëvendës Kryesues i Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB). Gjatë vizitës, Komisionerja Krenare Sogojeva-Dërmaku dhe Komisioneri Vukić zhvilluan takim me përfaqësues të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit akademik në ngritjen e kulturës institucionale të privatësisë.

NDËRGJEGJËSIMI NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE SAJËS NË DOKUMENTE PUBLIKE

Ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me institucionet publike dhe private për të siguruar respektimin e dyte drejtave, ka qenë në fokus të veprimeve të gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, me c’rast Agjencia ka vazhduar përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Në këtë drejtim, janë realizuar gjithsej **20 aktivitete informuese** dhe trajnime me mbi **450** zyrtar publik, kontrollues nga sektori publik dhe privat, përfaqësues të sektorit shëndetësor, sistemit bankar, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, ndërsa **227 pjesëmarrës** janë certifikuar në kuadër të trajnimeve të ofruara.

Në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Misioni i OSBE-së në Kosovë), Agjencia ka organizuar **5 punëtori** me temën “Mbrojtja e të Dhënave Personale në Sistemin Shëndetësor”, me pjesëmarrjen e rreth **120** profesionistëve nga **29 komuna të vendit**, përfshirë drejtues të institucioneve shëndetësore, mjekë, infermierë dhe staf tjetër mjekësor. Duke marrë parasysh natyrën e ndjeshme të të dhënave shëndetësore dhe rolin e drejtpërdrejtë të këtyre profesionistëve në përpunimin e tyre, trajnimet kanë shërbyer për forcimin e kapaciteteve dhe përafrimin e praktikave të përditshme me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në partneritet me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës dhe me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Agjencia ka organizuar një punëtori njëditore me temën “Sektori i Mediave dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale”, ku morën pjesë **11 përfaqësues** nga media të ndryshme në vend, me qëllim të fuqizimit të njohurive për trajtimin e përgjegjshëm të të dhënave personale në raportimin mediatik.

Ndërsa, në kuadër të projektit “Fuqizimi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Sigurisë Kibernetike në të Gjithë Sektorët në Kosovë”, dhe në bashkëpunim me Platformën CIVIKOS dhe Institutin për Teknologji dhe Shoqëri – me mbështetje nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës – janë realizuar **4 sesione informuese** me temë “Forcimin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Nivel Lokal” në komunat e Gjilanit, Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit. Në këto sesione morën pjesë gjithsej **113 përfaqësues** nga institucione publike, shoqëria civile dhe sektori privat, me synim rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e të dhënave në nivel lokal. Paralelisht, janë zhvilluar **3 trajnime certifikuese** për zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të nivelit qendror, me pjesëmarrjen e **65 zyrtarëve**, të cilët patën mundësinë të certifikohen nga TRECCERT – një institucion ndërkombëtar i njohur për vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale në fushën e privatësisë.

Përveç kësaj, Agjencia, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ka organizuar **6 trajnime** për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndara për institucione të nivelit qendror dhe lokal, agjenci të pavarura, ndërmarrje publike dhe institucione rregullatore, me gjithsej **138 zyrtarë** të trajnuar. Trajnimet janë zhvilluar nga Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kanë synuar fuqizimin e njohurive praktike dhe zbatimin e detyrimeve ligjore nga zyrtarët përgjegjës. Në kuadër të mandatit mbikëqyrës për garantimin e së drejtës për informim, është realizuar gjithashtu një trajnim dedikuar qasjes në dokumente publike, ku janë trajnuar **24 zyrtarë** nga institucione të ndryshme publike.

